REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

**Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit**
**Nr.07/351/01-23260**
**Dt. 16.11.2017**

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Naser (Enver) Lleshi** nga Gjakova, për dhënien e Lejes së Ndërtimit, për ndërtimin – ngritjen e katit mbi objektin ekzistues të banimit individual, renovimin e kateve ekzistuese dhe aneksin në katin e parë dhe përdhese, me etazhitet të përgjithshëm të objektit P+2, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, Udhëzimit Administrativ nr. 06/2017, për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për Kushte Ndërtimore, Leje ndërtimore dhe Leje Rrënimi, për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr. 05/L-031 nenit 21, 44 dhe 97 bien këtë:

# A K T V E N D I M

**I. I LEJOHET: aplikuesit: Naser (Enver) Lleshi** nga Gjakova, ndërtimin – ngritja e katit mbi Objektin ekzistues të banimit individual dhe renovimi i kateve ekzistuese dhe aneksin në katin e parë dhe përdhese, sipas projektit kryesor të prezantuar, në përputhshmëri me Planin Rregullues Urban "Orize", në ngastrën kadastrale me numër 5123/3, Z.K. Gjakovë –J- Qytet, në rrugën "Londra", në pronësi të lartë përmendurit, e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin dhe renovimin e objektit në fjalë, etazhiteti i objektit është P+2, me sipërfaqe të tërësishme të objekti i cili do të rinovohet dhe psipërfaqes së re për ndërtim **S= 511.00 m².**

**Përdhesa:** **(Sip,Bruto):** **S= 173.00 m²**
**Kati i parë:** **(Sip,Bruto):** **S= 169.00 m²**
**Kati i dytë:** **(Sip,Bruto):** **S= 169.00 m²**

**II.** Hartimin e projektit kryesor për renovimin dhe ndërtim të objektit ekzistues të banimit individual, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë ndërmarrja ndërtimore projektuese ndërtimore N.N."ARIS-Deçan.

**III.** Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

**IV.** Investitori është i obliguar që:

- Të të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Pa pëlqimin e hartuesit të projektit ideor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspekcionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve.

**V.** Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

# A r s y e t i m

**Naser (Enver) Lleshi** nga Gjakova, me banim në rrugën "Londra" nr.2, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351/01-23260 të datës 15.11.2017 për dhënien e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin – ngritjen e katit mbi objektin ekzistues të banimit individual, renovimin e kateve ekzistuese dhe aneksin në katin e parë dhe përdhese, me etazhitet të përgjithshëm të objektit P+2, në ngastrën kadastrale me numër 5123/3, Z.K. Gjakovë –J- Qytet, në rrugën "Londra", në pronësi të lartë përmendurit, siç është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:500 të datës 14.11.2017, të vërtetuar nga DUMM- Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 10.10.2017 në pronësi të Naser (Enver) Lleshi nga Gjakova, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Certifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme me numër të lëndës 5090/17 të datës 10.10.2017, të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Aktin Noterial – Autorizim, me numër LRP.Nr.9192/2017, dt.10.10.2017.
5. Deklaratën Noteriale me numër LRP NR.rend 4861/2017.
6. Aktvendimin – Lejen Ndërtimore me nr 04/2-351-30/71, të datës 12.01.1971, nga Drejtorati i Shërbimeve Shoqërore i Komunës së Gjakovës.
7. Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë, numër 430/a/355, të datës 13.10.2017.
8. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në Unionin Financiar të Kosovës, filiali Gjakovë, me datë 15.11.2017.
9. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje të forta dhe 1(një) CD, i punuar nga ndërmarrja ndërtimore projektuese ndërtimore N.N."ARIS-Deçan.

**Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 1813.20 Euro.**

**KËSHILLË JURIDIKE:**
Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

**Aktvendimi i dorëzohet:**

- **Investitorit,**
- **Drejtorisë së Inspekcionit,**
- **Arkivit.**

**Zyrtar i lartë për çështje juridike**

**Zenel Shabani, jur. i dipl.**

**U.D. Drejtori**

**Elida Bejtullahu, inxh.e dipl.e ark.**

K.K. GJAKOVË
Z.K. :Gj.j.Qytet
Ng. nr. 5123-3

# PLAN SITUACIONI




***LOKACIONI: NASER LLESHI***

*Aprovohet lokacioni per ngritjen e katitte dyte mbi objektin e ekzistues dhe anekset e evidentuara*

Gjendja Faktike
Gjendja Kadastrale

Gjakovë;
14.11.2017

Punoi:
Fatmir Bobi tek.

Vërteton urb.
Mirlinda Mullahasani I.D.A.

Vërtetoi : N.P.SH."**GELI**"
DREJTORI

14.11.2017
Takeometri preqize
Auto CAD 2004

Punoi : *Xhelal F. Zhubi inxh. i dip. i gjeod.*

*Frrok Hajdaraj*

Kuvendi Komunës GJAKOVË
Drejtoria për Kadaster Gjeodezi dhe Prone

# KOPJE PLANI

Zona kad.Gjakove Jashte Qytet
Poseduesi: 1 /1 Lleshi Naser (Enver)

Shk. zvog. 1: 500




Numri rendor i regjistrit të taksave kadastrale: ______________________

| Nr. Parcelës | Plani | Vendi i quajtur | Kultura | Klasa | Sipërfaqja | | | Vërejtjet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Ha | a | m ² | |
| 5123-3 | - | - | jo pjellore | - | 0 | 03 | 84 | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | Gjithësejtë | | 0 | 03 | 84 | |

Që kjo kopje e planit është besnike e origjinalit të vet sipas gjendjes në kadastër duke paguar taksën sipas vendimit të KK GJAKOVË.

VËRTETON:
Arber Jusufi

Gjakovë 10.10.2017